


**KUVENDI I
KOMUNËS KAÇANIK
-Shërbimi i Kuvendit-**



**MUNICIPALITY
ASSEMBLY OF
KACANIK**

**BULETINI
PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS
01.01.2007-17.11.2007**

**KAÇANIK
Nentor,2007**

HYRJE

Ky Buletin përfshinë aktivitetin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut gjat vitit 2007.

Buletini përmban aktivitetin që ka zhvilluar Kuvendi i Komunës për gjatë periudhës 01.01.2007-17.11.2007 dhe është pjesë përbërese e Buletinit për Aktivitetit të Punës së Kuvendit të Komunës 26.10.2002-31.12.2006.

Bazë për përpilimin e këtij Buletini kanë shërbyer procesverbalet e përpiluara gjat punës së kuvendit.

Qëllimi i këtij Buletini është pasqyrimi i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës për gjat kësaj periudhe, sistemimi i tyre dhe njoftimi i strukturave komunale në drejtim që të jet sa më transparent aktiviteti i zhvilluar.

Buletini është përpiluar nga shërbimi për punë profesionale të Kuvendit të Komunës dhe ky shërbim është mirënjohës për të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet të cilat do të ipen në të. Këto vërejtje dhe sugjerime do të ndihmojnë që aktiviteti në punën e ardhëshme të jetë më i suksesshëm dhe cilësor.

PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i dalur në zgjedhjet e dyta vendore të mbajtura më 26.10.2002, numëron gjithsej 31 anëtarë. Më përbërjen e këtyllë ky kuvend ka punuar edhe në vitin 2007, mirëpo për gjat vitit 2007 përbërja e kuvendit në spektrin politik pëson ndryshime me atë që anëtari: Shyqeri Luzha nga LDK kalon në LDD, nderkaq Sherife Troni nga LDK vepron e pavarur.

AKTIVITETI I KUVENDIT TË KOMUNËS

viti 2007

Mbledhja e I-rë(Parë)

Mbledhja e I-rë e Rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datë: 31.01.2007, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

1. Aprovon Vendimin për caktimin e orarit të Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,
2. Aprovon Raportin e Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2006,
3. Aprovon Planin e aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për periudhën :janar-maj 2007.

Mbledhja e II-të(Dytë)

Mbledhja e II-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës, është mbajtur më datë:27.02.2007, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje, Kuvendi i Komunës;

1. Aprovon Vendimin për ndryshim plotësimin e Rregullorës për vendosjen e Tatimit në Pronë në teritorin e komunës së Kaçanikut për vitin 2007,
2. Aprovon Raportin e Punës së Komitetit për Ndërmjetësim.

Mbledhja e III-të(Tretë)

Mbledhja e III-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datë: 27.03.2007, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje, Kuvendi i Komunës;

- 1.Aprovon Raportin e Punës së Komitetit të Komuniteteve,
- 2.Merr Vendim për zhvillimin e diskutimit publik të Rregullorës për Transportin Rrugor në Teritorin e Komunës së Kaçanikut,
3. Aprovon Vendimin për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të Komunës së Kaçanikut.

Mbledhja e IV-të(Katërt)

Mbledhja e IV-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës, është mbajtur me datë: 02.05.2007, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

1. Aprovon Raportet e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2006,
- 3.Aprovon Raportin për realizimin e mjeteve bugetore në nivel të komunës për vitin fiskal 2006.

Mbledhja e V-të(Pestë)

Mbledhja e V-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datë : 28.05.2007 është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

1. Aprovon Programet e Punës së Drejtorive Komunale, për vitin 2007,
2. Aprovon Planin e Veprimit për Transparencë në komunën e Kaçanikut,
3. Aprovon Vendimin për shtimin e tarifave dhe ngarkesave në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Punë Komunale Banesore,

4. Aprovon Propozimet për Veprimet e nevojshme që duhet ndermirren nga organet e administrates komunale konform rekomandimeve të Zyrës Gjenerale të Auditimit.
5. Aprovon Vendimin për caktimin e vendit për ndertimin e Zyrës së Vendit në Doganaj

Mbledhja e VI-të (Gjashtë)

Mbledhja e VI-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datë 29.06.,2007, është kyesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës ;

- 1.Aprovon Ekstraktin e Procesverbalit nga debatit publik më qytetarë lidhur më Rregullorën e transportit Rrugor në teritorin e komunës së Kaçanikut,
- 2.Aprovon Vendimin për formimin e komisionit profesional nga lëmia e trafikut rrugor urban dhe urbano-periferik të komunës së Kaçaniku, në këtë përbërje;
-Sabit Raka, kryetar,
-Sahit Bela, anëtar,
-Nuhi Jakupi, “
-Menduh Krasniqi, “ dhe
-Bekim Terziu “.
3. Aprovon Rregullorën e Transportit Rrugor në teritorin e Komunës së Kaçanikut.

Mbledhja e VII-të(Shtatë)

Mbledhja e VII-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më date: 16.07.2007, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje, Kuvendi i Komunës;

1. Aprovon Vendimin për Rishikimin Gjashtmuor të Komunës për vitin 2007,
2. Aprovon Raportin për realizimin e mjeteve bugjetore për periudhën janar-qershor 2007,
3. Merr Vendim për hartimin e një shkrese reaguese më të cilën shkresë Reagohet për shtyrjen e zgjedhjes se Statusit Politik të Kosovës,

4. Debatoj për çeshtjen e ndotjes se dy lumenjeve “ Lepenc e Nerodime” nga ndermarrje “Silcapri”.

Mbledhja e VIII-të (tetë)

Mbledhja e VIII-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më datë 27.09.2007, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje, Kuvendi i Komunës;

1. Aprovon Rregullorën për vendosjen e Tatimit në Pronë në teritorin e komunës së Kaçanikut,
2. Aprovon Vendimin për Bugjetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2008 dhe vlerësimet për vitin 2009-2010,
3. Merr Vendim për formimin e komisionit për emërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kaçanik, në këtë përbërje;

1. Xhelal Gashi, kryetar,
2. Bahrie Çaka, anëtar dhe
3. Ali Brati , “ .

Mbledhja e IX-të(Nëntë)

Mbledhja e IX-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur më date 24.10.2007, është kryesuar nga Xhelal Gashi, kryetar.

Në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës;

1. Aprovon Rregullorën për pagesën e Tarifave dhe Ngarkesave Administrative dhe Shërbimeve tjera komunale,
2. Aprovon Vendimin për vazhdimin e mandatit të organeve ekzekutive të komunës(kryeshefit ekzekutiv dhe antarëve të Bordit të Drejtorëve), deri më konstituimin e kuvendit,
3. Aprovon Vendimin për Bugjetin e Komunës së Kaçanikut për vitin 2007 ,
4. Aprovon Vendimin për Rishikimin gjashtëmuor të Bugjetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2007,
5. Merr Vendim për prolongimin e çeshtjes së emërtimit të QKMF.

Kuvendi i Komunës për gjat vitit 2007 ka mbajtur 1 takim me qytetarë të komunës së Kaçanikut .

Gjat vitit 2007 Kuvendi i Komunës ka mbajtur një mbledhje me karakter solemn, dhe ate;

Më datë 11.06.2007 Kuvendi i Komunës ia kushton një mbledhje solemne 11 Qershorit ,Ditës së Çlirimit të Komunës së Kaçanikut. Në këtë Ditë në prani të mysafirve të ftuar dhe qytetarëve të shumët të komunës se Kaçanikut ,është bërë **Shpalosja e Shtatores së dëshmorit të kombit -Komandantit të UÇK-së Agim Bajrami në Kaçanik.**

Zgjedhjet e Kosovës janë caktuar të mbahen për datë:17 Nentor 2007. Në këto zgjedhje do të votohet për zgjedhjen e Kuvendit të Kosovës,për zgjedhjen e Kuvendin Komunal dhe për zgjedhjen e Kryetarit të komunës.

Fushata zgjedhore ka filluar nga data 25.10.2007.

SHËRBIMI I KUVENDIT
Makfire Malsiu, juriste e dipl.